



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**  
**SEKRETARIA**

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .07.2020

**NJOFTIM**

**Për mbledhjen Nr. 29, datë 17.07.2020, ora 10:00**  
**të Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 17.07.2020, ora 10:00** do të zhvillohet mbledhja nr. 29 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

- 1- Mbi licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakice)
- 2- Mbi licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë)
- 3- Mbi kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a., për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të bordit të ERE
- 4- Mbi kërkesën e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të bordit të ERE-s
- 5- Mbi licencimin e shoqërisë “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik lundruës mbi rezervuarin e hec banja me kapacitet të instaluar 2 MW
- 6- Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a. për pezullimin e procedurës administrative për rishikimin e vendimit të ERE nr. 73/2020, mbi miratimin e “Kontratë tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e të cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/FSHU për furnizimin e klientëve fundorë”
- 7- Çështje të tjera

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019”; Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore” dhe Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**